



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.04.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, për ndihmës ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarë dhe/ose për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2023-2024.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:55 dhe mbaroi në orën 16:44.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, për ndihmës ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarë dhe/ose për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2023-2024.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, sot për shkak të urgjencës, janë dy çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit. Bëhet fjalë për miratimin e listës emërore për kandidatët që

plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, për ndihmësit ligjorë.

Gjithashtu projekt-akti tjetër për të cilin kërkohet vendimmarrje ka të bëjë me shqyrtimin e komenteve dhe miratimin e komenteve dhe sugjerimeve mbi rezultatet e vlerësimit paraprak të bërë nga Shkolla e Magjistraturës për kandidatët që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2023–2024.

Të dy këto projekt-akte vijnë në mbledhje plenare si propozim të Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, komision i cili është ngritur me vendim të Këshillit, në mënyrë të posaçme për vitin akademik 2023-2024.

Pa humbur kohë, dëshiroj t’ia jap fjalën kryetarit të këtij Komisioni, zotit Rusi, i cili do të relatojë gjetjet dhe propozimet përkatëse.

Ilir Rusi: Faleminderit, Kryetare!

Relacion “Mbi projektvendimin “Për miratimin e listës emërore të kandidatëve për ndihmës ligjorë që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024””.

Bazuar në nenet 53, 55 dhe 56 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 274 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriteve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë që do të pranohen për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, në respektim të procedurës së përcaktuar në ligj dhe në vendimin nr.424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriteve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka kryer verifikimin e plotësimit të kriteve, bazuar në

dokumentacionin e paraqitur nga çdo kandidat.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 02.03.2023, Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor listën përfundimtare me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) kandidatë, që kanë shprehur vullnetin për të qenë kandidatë për ndihmës ligjorë. Nga verifikimi rezulton se: 75 (shtatëdhjetë e pesë) kandidatë plotësojnë kriteret për ndihmës ligjorë; 6 (gjashtë) kandidatë janë me mesatare të lëndëve kryesore 7 (shtatë), ndërsa 16 (gjashtëmbëdhjetë) kandidatë nuk plotësojnë kriteret për ndihmës ligjorë.

Për aplikuesit që janë kualifikuar për të kaluar në fazën e testimit për pozicionin ndihmës ligjorë, për aplikantët me mesatare 7 (shtatë), si edhe për ata që nuk janë kualifikuar, Komisioni i Përkohshëm ka vlerësuar të mbajë të njëjtin qëndrim, siç ka mbajtur edhe më parë Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë procedurës së verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2020 – 2021, 2021 – 2022 dhe 2022 – 2023, si dhe qëndrimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, profili gjyqtar, për vitet akademike 2020 – 2021, 2021 – 2022 dhe 2022 – 2023, në kushtet kur një pjesë e kandidatëve aktualë për ndihmës ligjorë kanë aplikuar dhe në këto vite si kandidatë për magjistratë.

Gjatë procedurës së verifikimit, nga ana e Komisionit të Përkohshëm u konstatuan disa problematika për 18 (tetëmbëdhjetë) kandidatë gjithsej, si më poshtë vijon:

a) Për aplikantët, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, dhe znj. {...}, u konstatuan parregullsi në datat e deklaratave të parashikuara në nenin 6, shkronjat “e” “ë” dhe “f” të vendimit nr. 55, datë 31.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

b) Për aplikantët znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...} në listën e notave u konstatua mungesa e lëndës “E drejtë e Detyrimeve”, e cila është një nga lëndët e vendosura për caktimin e mesatares në grupin e lëndëve kryesore.

c) Për aplikantët z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, u konstatua mungesa e dokumentit librezë pune, dokument që duhet të paraqesë kandidati për ndihmës ligjor në dosjen personale për regjistrim, sipas parashikimeve të nenit 7 shkronja “e”, e vendimit nr. 55, datë 31.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

ç) Gjithashtu u konstatua mungesa e diplomës së huaj për kandidatët z. {...} dhe znj. {...}, si dhe mungesa e diplomës “Master” për kandidaten znj. {...}.

d) Për kandidatët z. {...} dhe z. {...}, u konstatua se nuk është e përcaktuar data e fillimit dhe e përfundimit të ciklit të studimeve “Bachelor”.

dh) Kandidates znj. {...}, i mungon raporti mjeko-ligjor.

e) Ndërsa kandidates znj. {...}, u konstatua që i mungon certifikata e gjendjes gjyqësore, si dhe lista e notave “Master”.

ë) Për kandidatin z. {...}, u konstatua mungesë në dokumentacionin që vërteton përvojën profesionale.

Me anë të postës elektronike, në datë 23.03.2023 iu dërgua e-mail të gjithë kandidatëve të sipërpërmendur (gjithsej 18 kandidatë), duke i informuar mbi parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara nga Komisioni i Përkohshëm, dhe duke i caktuar si afat për plotësimin e tyre datën 27.03.2023.

Nëpërmjet postës elektronike si dhe me anë të depozitimit pranë zyrës së protokollit të KLGJ-së, kandidatët dërguan informacion/plotësuan dokumentacionin e kërkuar (për të cilët është shënimi përkatës në skedën e gjithsecilit prej kandidatëve në lidhje me korrespondencën e mbajtur).

III. Për sa i përket skualifikimeve të aplikantëve për të marrë pjesë në provimin e pranimit për ndihmës ligjorë, nga Komisioni i Përkohshëm janë arritur përfundimet si vijon:

1. Për aplikantët znj. Elona Ibrahim, znj. {...}, dhe znj. {...}, Komisioni i Përkohshëm ka vendosur të propozojë moskualifikimin e tyre për të marrë pjesë në provimin e pranimit për ndihmës ligjorë, për shkak se kanë rezultuar me notë mesatare të përgjithshme dhe për grupin e lëndëve kryesore nën 7.

2. Gjithashtu, për aplikantin z. {...}, Komisioni i Përkohshëm ka vendosur të propozojë moskualifikimin e tij për të marrë pjesë në provimin e pranimit për ndihmës ligjorë, për shkak se ka rezultuar me notë mesatare të përgjithshme nën 7.

3. Për aplikantët znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, Komisioni i Përkohshëm ka vendosur të propozojë moskualifikimin e tyre për të marrë

pjesë në provimin e pranimit për ndihmës ligjorë, për shkak se kanë rezultuar me notë mesatare për grupin e lëndëve kryesore nën 7 (shtatë).

4. Për aplikantët, z {...}, znj. {...}, znj. {...} znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, Komisioni i Përkohshëm ka vendosur të propozojë moskualifikimin e tyre për të marrë pjesë në provimin e pranimit për ndihmës ligjorë, për shkak se ka rezultuar që nuk plotësojnë kriterin e përvojës profesionale.

Kriteri i mesatares është vendosur si një nga kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati me vendimin nr.55, datë 31.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht në pikën 6, shkronja “gj” të tij.

Për përlllogaritjen e kriterit të mesatares (të përgjithshme dhe të lëndëve kryesore), janë marrë për bazë vlerësimet e marra përgjatë kryerjes/përfundimit/diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare, programi studimi 4-vjeçar DIND, program studimi i integruar 5-vjeçar, dhe studime te ciklit të parë (Bachelor) së bashku me studimet e ciklit të dytë (Master Shkencor).

Ndërsa kriteri i përvojës profesionale, është vendosur si një kriter i veçantë që duhet të plotësojë kandidati me vendimin nr.55, datë 31.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht në pikën 6, kriteret e veçanta, shkronja “a”, e tij.

Përmbushja e kriterit të përvojës profesionale, është përlllogaritur që nga data e përfundimit/diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare, program studimi 4-vjeçar DIND, program studimi i integruar 5-vjeçar, dhe studime te ciklit të parë (Bachelor) së bashku me studimet e ciklit të dytë (Master Shkencor), deri në datën e mbylljes së aplikimeve, 28 shkurt 2023.

Ajo që duhet të theksohet, duhet të theksohet një lapsus që është bërë materialin e përcjellë, në lidhje me propozimin e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kriterëve, në lidhje me kandidatët për ndihmës ligjorë, sa i përket kandidatit z. {...}, për të cilin janë reflektuar qëndrimet të cilat janë në fuqi dhe të reflektuara edhe në vendimmarrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kështu që materiali i cili i është përcjellë mbledhjes plenare për sa i përket z. {...} është një lapsus, sepse ka qenë një material pa përmendjen e zotit {...} në lidhje me këtë relacion.

Për kandidatët z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, rezultuan me notë mesatare të lëndëve kryesore 7 (shtatë), por vlen të theksohet që qëndrimi i mëparshëm i vitit të kaluar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ka qenë që me këtë mesatare, kur është e plotë dhe nuk është mbi 7 (shtatë), ka vendosur kualifikimin e kandidatëve përkatës.

Së fundi, projektvendimit i bashkëlidhen edhe tre lidhje që janë pjesë përbërëse të tij:

1. Lista e kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit për ndihmës ligjorë;

2. Lista e kandidatëve që nuk kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit për ndihmës ligjorë.

3. Lista e kandidatëve me mesatare të lëndëve kryesore 7 (shtatë).

Tek lista e kandidatëve që nuk kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit për ndihmës ligjorë, vlen të theksohet fakti që do reflektohet lapsusi në lidhje me kandidatin {...}, i cili do përfshihet tek lidhja e kandidatëve të kualifikuar.

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutim, kalojmë në votim, sipas propozimit të bërë nga zoti Rusi, bashkë me reflektimin e lapsusit lidhur me një prej kandidatëve. E hedhim në votim? (*ripërsëritet kërkesa për hedhje në votim*).

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Të miratojë listën emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024, për Ndihmës Ligjorë, sipas Lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të miratojë listën emërore të kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për të marrë pjesë për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024, për Ndihmës Ligjorë, sipas Lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.04.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2023-2024””, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarë dhe/ose për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2023-2024.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:55 dhe mbaroi në orën 16:44.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2023-2024””, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarë dhe/ose për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2023-2024.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër i cili në fakt edhe ky ka lidhje me kandidatët magjistratë, të profilit gjyqtar. Për më shumë detaje në fakt ia jap sërish fjalën zotit Rusi.

Ilir Rusi: Faleminderit e nderuar Kryetare!

Për sa i përket procedurës në lidhje me kandidatët për profilin gjyqtar, kemi përgatitur si Komision komentet dhe sugjerimet mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2023-2024.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 55, datë 31.01.2023, ka përcaktuar, ndër të tjera, edhe numrin e kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar, që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024.

Pas këtij vendimi, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, në datën 31.01.2023, ka vendosur të publikojë thirrjen për kandidime për pranimin në formimin fillestar për magjistrat. Po ashtu, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka miratuar edhe përbërjen e Komisionit të Administrimit të Provimit. Në vendim është përcaktuar gjithashtu edhe periudha e regjistrimit për kandidatët në formimin fillestar, në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr. 96/2016.

Me anë të njoftimit publik janë informuar të gjithë të interesuarit për fillimin e procedurës së aplikimeve, periudhën gjatë të cilës Shkolla e Magjistraturës do të pranonte dhe mblidhte dokumentacionin e personave të interesuar, fazat e zhvillimit të provimit të pranimit, kriteret që duhet të plotësoheshin sipas rastit, të parashikuara në nenin 28 të ligjit “Për statusin”, si dhe në nenin 10 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, si dhe për dokumentet që duhet të dorëzohen nga personat e interesuar, parashikuar në nenin 11 të Rregullores.

Për gjatë periudhës 1 deri në 28 shkurt 2023, Sekretaria Shkencore për Formimin Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës ka pranuar aplikimet nga personat e interesuar për të marrë pjesë në provimin e pranimit. Gjatë periudhës së regjistrimit, personat që kanë shprehur interesin dhe kryer procedurat e regjistrimit për të marrë pjesë në konkurs janë në total 451 (katërqind e pesëdhjetë e një) aplikantë për kandidatë për gjyqtar, prokuror dhe ndihmës ligjor. Pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët për magjistratë, Komisioni përkatës i ngritur për vlerësimin paraprak të

dokumentacionit konstatoi se:

- 404 (katërqind e katër) aplikantë kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga Shkolla e Magjistraturës për të aplikuar për kandidat për magistrat, profili gjyqtar;

- 362 (treqind e gjashtëdhjetë e dy) aplikantë janë kualifikuar pasi kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në ligj dhe Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës;

- 42 (dyzetë e dy) aplikantë janë skualifikuar për shkak se nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në ligj dhe Rregulloren e Brendshme të Shkollës.

Në vijim, raporti për rezultatet e vlerësimit paraprak, si dhe dokumentacioni i kandidatëve, i janë përcjellë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në respektim të pikës 4, të nenit 30, të ligjit “Për statusin”, sipas të cilit: “1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti. 2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit. 3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. 4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij. 5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe aktet nënligjore përkatëse.”

Sipas dispozitës së mësipërme, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të japë komente

ose kundërshtime, në lidhje me rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve nga Shkolla e Magjistraturës duke qenë kjo e fundit organi përgjegjës kompetent për të vendosur përfundimisht për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, pra për kualifikimin ose përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në provimin e pranimit për në formimin fillestar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin që komentet dhe sugjerimet e tij t'i bazojë në ligj, pikërisht referuar kriterëve të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit “Për statusin”, sipas të cilit: “Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; c) ka përfunduar me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, të barasvlershëm me to, ose ka kryer me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet universitare në drejtësi jashtë Shqipërisë dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj; ç) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, pas përfundimit të studimeve të integruara në drejtësi [...]”.

Kriteret e mësipërme ligjore janë detajuar më tej në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, konkretisht neni 10 i saj.

Referuar kriterëve të pranimit në formimin fillestar, Këshilli i Lartë Gjyqësor konsideron bërjen e komenteve dhe sugjerimeve në lidhje me rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës për aplikantët që kanë kandiduar për magjistrat, profili gjyqtar, me qëllim që ato të vlerësohen nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të miratimit të raportit të vlerësimit përfundimtar.

Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, i ngritur me vendimin nr.67, datë 09.02.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të detyrimeve ligjore, sipas praktikave të mëparshme, bën komente dhe sugjerime mbi raportin e vlerësimit paraprak të Shkollës së Magjistraturës.

I. Komete dhe sugjerime për aplikantët që janë vlerësuar paraprakisht se përmbushin kriteret ligjore:

a) Kandidat i kualifikuar nga Shkolla e Magjistraturës, për të cilët sugjerohet rishikimi për shkak të mesatares së përgjithshme dhe mesatares së lëndëve kryesore, të cilat rezultojnë nën 8.

Për aplikantin, {...}, për të cilin është vlerësuar se përmbush kriterin e mesatares së përgjithshme dhe mesatares së lëndëve kryesore, sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur, pasi nga përlllogaritjet e bëra duket që mesatarja për këtë kandidat rezulton nën 8, pra e ndryshme nga ajo e evidentuar në rezultatet e vlerësimit paraprak.

b) Kandidatë të kualifikuar nga Shkolla e Magjistraturës për të cilët sugjerohet rishikimi për shkak të mesatares së lëndëve kryesore e cila rezulton nën 8.

Për aplikantët, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} për të cilët është vlerësuar se përmbushin kriterin e mesatares së grupit të lëndëve kryesore, parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronja “d”, e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur, pasi nga përlllogaritjet e bëra duket që mesatarja për secilin nga këta kandidatë rezulton nën 8, pra e ndryshme nga ajo e evidentuar në rezultatet e vlerësimit paraprak. Siç u evidentua më lart, ky rishikim i mesatares së përgjithshme dhe mesatares për grupin e lëndëve kryesore për këta kandidatë, çmohet se çon Shkollën e Magjistraturës drejt një vlerësimi përfundimtar të kundërt me atë të paraprak, me pasojë skualifikimin e tyre. Përlllogaritje e mesatareve gjatë procedurës së vlerësimit në Këshill, është bazuar në metodologjinë e përcaktuar në nenin 10 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Për aplikanten {...} për të cilën është vlerësuar se përmbush përvojën profesionale parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronja “f”, e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, sugjerohet rivlerësimi i përvojës profesionale.

Referuar dokumentacionit të administruar në praktikën e aplikantes rezulton se znj. {...} ka përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë, me kohë të plotë, duke u diplomuar në datë 18.09.2020 në Master i Shkencave në Politika dhe Administrim-Profil

Administrim Publik. Në praktikën e kandidatës znj. {...} është administruar vërtetimi nr. {...} prot., datë 23.01.2023 i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë me anë të së cilit vërtetohet se ushtron profesionin e avokatit pranë Dhomës së Avokatisë Durrës prej vitit 2015 e në vazhdim. Ndërsa sipas librezës së punës rezulton se aplikantja ka qenë e punësuar si avokate pranë Personit Fizik, Av. {...} nga data 01.09.2020-31.01.2021 dhe pranë Studios ligjore {...}, në pozicionin avokate, nga data 02.02.2021 e në vijim.

Në shkronjën “ç” të nenit 28 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr.50/2021, përcaktohet se çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, pas përfundimit të studimeve të integruara në drejtësi sipas shkronjës “c” të këtij neni në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare. Në referim të kësaj dispozite për aplikanten znj. {...} përlllogaritja e përvojës profesionale ka filluar nga data e diplomimit më 18.09.2020. Pra në total aplikantja rezulton të ketë 2 vite 5 muaj dhe 11 ditë përvojë profesionale, më pak se 3 vjet.

Sa më lart, për aplikanten, znj. {...}, për sa i përket përmbushjes së kriterit të përvojës së nevojshme profesionale, pas përfundimit të plotë të studimeve universitare, sipas nenit 10 pika 1, shkronja “f”, të Rregullores së Shkollës, sugjerohet rivlerësimi i përvojës profesionale dhe kohëzgjatjes së saj pasi, sipas përlllogaritjes në bazë të dokumenteve të depozituar nga aplikantja, kjo e fundit duket që të ketë mbi tre vjet përvojë profesionale me kohë të plotë sikurse kërkohet nga neni 28, pika 1, shkronja “ç”, e ligjit “Për statusin”.

Vlen të theksohet edhe fakti se opinioni i shprehur mbi zotën {...} është një lapsus për shkak se në këtë material përfundimtar nuk do të jetë pjesë e këtij relacioni (të këtyre komenteve).

Për aplikantin {...} është vlerësuar se përmbush kriteret e parashikuara në nenin 10 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës.

Në praktikën e administruar të aplikantit është konstatuar mospërputhje në dokumentacion. Zoti Erindi ka përcjellë Diplomë “Master i Shkencave” në “E drejtë publike”, lëshuar nga Universiteti “Kristal”, të cilës i ka bashkëlidhur vërtetimin nr. {...} prot., datë 05.10.2011 si dhe listën e notave. Në vërtetim është përcaktuar se z. {...}, në përfundim të studimeve, është diplomuar në programin e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në të Drejtën Civile. Referuar dy dokumenteve të mësipërm, konstatohet një mospërputhje për sa i përket programit të studimit që ka kryer aplikanti në ciklin e dytë të studimeve “Master Shkencor”.

Pra, në listën e notave figuron emërtimi “Master i Shkencave” në të Drejtën Civile, ndërsa diploma e përcjellë nga kandidati i emërtohet “Master i Shkencave” në të Drejtë Publike.

Nga sa më lart, për aplikantin {...} vlerësojmë se është i nevojshëm rivlerësimi i kualifikimit të tij.

Lidhur me aplikantin z. {...} i cili është vlerësuar se përmbush kriteret e parashikuara në nenin 10 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, në praktikën e administruar është konstatuar mospërputhje në dokumentacion.

Konkretisht, zoti {...} ka përcjellë dokumentin “Diplomë Bachelor” në Drejtësi për vitet 2013-2016, “Master i Shkencave” në të Drejtë Civile, me datë diplomimi 2016-2018 lëshuar nga Universiteti i Tiranës, si dhe “Vërtetim Notash” datë 17.11.2022, (listë notash) e cila i përket “Masterit të Shkencave” në të Drejtë Penale, 2020-2022.

Nga sa më lart, për aplikantin {...}, vlerësojmë se është i nevojshëm rivlerësimi i kualifikimit të tij.

c) Kandidatë të kualifikuar nga Shkolla e Magjistraturës për të cilët mesatarja e lëndëve kryesore e cila rezulton 8.

Gjithashtu aplikantët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, rezultojnë me notë mesatare 8.

II. Komente dhe sugjerime për aplikantët që janë vlerësuar paraprakisht se nuk përmbushin kriteret ligjore:

a) Gjetje mbi kandidatët që janë skualifikuar, të cilat nuk e ndryshojnë statusin e

tyre si të skualifikuar.

Në bazë të pikës 4/d të nenit 10 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se një ndër kriteret që duhet të përmbush kandidati për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, është d) ka notë mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë), si dhe notë mesatare mbi 8 (tetë) për grupin e lëndëve kryesore, ku përfshihen: E drejta civile dhe e detyrimeve dhe kurset e saj të thelluara dhe të posaçme, E drejta penale (pjesa e përgjithshme dhe pjesa e posaçme) dhe kurset e saj të thelluara dhe të posaçme; Procedura civile dhe kurset e saj të thelluara dhe të posaçme; Procedura penale dhe kurset e saj të thelluara dhe të posaçme; E drejta administrative dhe kurset e saj të thelluara dhe të posaçme; E drejta kushtetuese dhe kurset e thelluara të posaçme.”

Në referim të kësaj dispozite ligjore, paraqiten sugjerimet dhe kundërshtimet për kandidatët si më poshtë:

-Për aplikantët {...}, {...}, për të cilin është vlerësuar se përmbush kriterin e mesatares së grupit të lëndëve kryesore, parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronja “d”, e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur, pasi nga përlllogaritjet e bëra duket që mesatarja për këtë kandidatë është nën 8.

- Për aplikanten {...} për të cilin është vlerësuar se përmbush kriterin e mesatares së përgjithshme, parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronja “d”, e Rregullores, sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur, pasi nga përlllogaritjet e bëra duket që mesatarja për këtë kandidatë është nën 8.

-Për aplikantin {...} për të cilin është vlerësuar se nuk përmbush kriterin e mesatares së përgjithshme, parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronja “d”, e Rregullores, sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur, pasi nga përlllogaritjet e bëra duket që mesatarja për këtë kandidatë është mbi 8.

b) Gjetje mbi kandidatin e skualifikuar, e cila e ndryshon statusin e tij si të skualifikuar.

-Për aplikantin {...} për të cilin është vlerësuar se nuk përmbush kriterin e mesatares së lëndëve kryesore, parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronja “d”, e

Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur, pasi nga përlllogaritjet e bëra duket që mesatarja për këtë kandidat është 8.

III. Në lidhje me gjetjet mbi shkaqet e skualifikimit të kandidatëve:

1. Për znj. {...}, Komisioni i verifikimit paraprak të dokumentacionit, vlerëson se aplikantja nuk përmbush kriterin e mesatares përgjithshme dhe mesatares të grupit të lëndëve kryesore, parashikuar nga neni 10, pika 4, të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, pasi mesatarja e përgjithshme rezulton në masën 7.59 dhe mesatarja e grupit të lëndëve kryesore në masën 6.62.

Sugjerohet rishikimin e komentit pasi mesatarja e lëndëve kryesore sipas tabelës së Shkollës së Magjistraturës rezulton 7.33. Gjithashtu duhet të shtohet edhe mospërmbushja e kriterit sipas nenit 28, germa “ç”, i ligjit nr. 96/2016, dhe nenit 10, pika 4/f e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë si jurist, pas diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare. Kjo pasi vjetërsia në punë si juriste pas përfundimit të ciklit të plotë të studimeve (Master i Shkencave) rezulton 1 vit.

2. Për znj. {...}, Komisioni i verifikimit paraprak të dokumentacionit, vlerëson se aplikantja nuk përmbush kriterin e mesatares të grupit të lëndëve kryesore, parashikuar nga neni 10, pika 4, germa “d”, të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, pasi mesatarja e grupit të lëndëve kryesore është në masën 6.38.

Sugjerohet riformulimin e komentit pasi mesatarja e lëndëve kryesore sipas tabelës së Shkollës së Magjistraturës rezulton 7.33. Gjithashtu duhet të shtohet edhe mospërmbushja e kriterit sipas nenit 28, germa “ç”, i ligjit nr. 96/2016, dhe nenit 10, pika 4/f të Rregullores së Brendshme, ku të paktën të ketë tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë si jurist, pas diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare. Kjo pasi vjetëria në punë si juriste pas përfundimit të ciklit të plotë të studimeve (Master i Shkencave) rezulton 6 muaj.

Këto ishin komentet në lidhje me kandidatët.

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Rusi!

Ndonjë diskutim?

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Atëherë, para së gjithash vlerësoj analizën që kanë bërë kolegët në përputhje edhe me aktet e shumta që kanë pasur në dispozicion për të nxjerrë opinionet e tyre. Gjithsesi do dëshiroja të ndaloja pak tek aplikanti {...} për të cilin rekomandimi është “vlerësojmë se është i nevojshëm rivlerësimi i kualifikimit të tij”. Ndërkohë që, aktualisht në këtë rekomandim opinion mungon krejtësisht arsyetimi se cili është shkaku për të cilën Shkolla e Magjistraturës duhet ta rivlerësojë këtë kandidaturë, këtë aplikant, duke pasur parasysh që kriteret që kërkon neni 28/c në lidhje me përfundimin e studimeve të integruara në drejtësi ose një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, të barasvlershme me to, si dhe përcaktimet që ka dhënë neni 75 i ligjit “Për arsimin e lartë” i cili konsideron që cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit “Master shkencash”, “Master i arteve”, “Master profesional”, referuar nivelit të shtatë Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Pra nën dritën e këtyre nocioneve dhe kriterëve të përcaktuar si nga neni 28/c dhe neni 75 i ligjit “Për arsimin e lartë”, unë do dëshiroja një shpjegim se cilat janë ato shkaqe ligjore të cilat na detyrojnë apo na kërkojnë t’i rekomandojmë Shkollës së Magjistraturës që të rivlerësojë këtë kualifikim. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Doja të theksoja faktin që pjesë e këtij komenti do të bëhet edhe qëndrimi që ne si Komision kemi mbajtur në rastin e verifikimit të kandidatëve për ndihmës ligjorë sepse ky Komision bën edhe verifikimin e vlerësimeve paraprake të nxjerra nga Shkolla e Magjistraturës në lidhje me kandidatët profili gjyqtar. Në relacionin të cilin përmenda për ndihmësit, i cili pas relativitetit do të bëhet pjesë edhe e këtyre komenteve, kemi vendosur dy kriteret (në perifrashim të përmbajtjes së tyre): kriteri i mesatares është vendosur si një ndër kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati përkatës.

Për përlogaritjen e kriterit të mesatares (të përgjithshme dhe të lëndëve kryesore), janë marrë për bazë vlerësimet e marra përgjatë kryerjes/përfundimit/diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare, program studimi 4-vjeçar DIND, program studimi i integruar 5-vjeçar, dhe studime të ciklit të parë (Bachelor) së bashku me studimet e ciklit të dytë (Master Shkencor).

Ndërsa në lidhje me kriterin e përvojës profesionale, jemi referuar që: Përmbushja e kriterit të përvojës profesionale, është përlogaritur që nga data e përfundimit/diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare, program studimi 4-vjeçar DIND, program studimi i integruar 5-vjeçar, dhe studime të ciklit të parë (Bachelor) së bashku me studimet e ciklit të dytë (Master Shkencor), deri në datën e mbylljes së aplikimeve.

Ajo që vlen të theksohet është që për shkak edhe të ndryshimeve që ka pësuar legjislacioni i arsimit të lartë, kemi një emërtesë të ndryshme të diplomave në kohë, sipas ligjit të kohës. Në përcaktimet e tyre, studimet e plota universitare janë studimet që kanë qenë në kohët e mëparshme, sipas ligjit të kohës, që kanë zgjatur 4 vjet, dhe ato me ndryshimet që ka pësuar ligji “Për arsimin e lartë” janë barasvlerësuar me “Master shkencor” Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND). Aktualisht në fushën e drejtësisë kemi një program të integruar të ciklit të dytë “Master i shkencave” në drejtësi program 5-vjeçar dhe përpara aplikimit të këtij programi janë ofruar programe studimi marrë nga sistemi i Bolonjës, që përfshin ciklin e parë të studimeve “Bachelor” dhe ciklin e dytë të studimeve (në këtë rast konkret) “Master shkencor” (sepse ka pasur edhe “Master profesional”). Kjo është ajo metodologjia, botëkuptimi dhe fryma e akteve në lidhje me ciklin e studimeve të plota universitare.

Në rastin konkret, sikundër dhe janë relatuar, ka një fillim të studimeve fillimisht në “Bachelor” të cilat janë kryer në periudhën 2013-2016, pasuar me një program të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” në të drejtën civile (2016-2018), dhe këtu përfundojnë ato që quhen studime të plota universitare, duke marrë në konsideratë këtë lloj sistemi arsimor të aplikuar në kohë dhe përcaktimet ligjore. Më tej, nga kandidati është bërë një master tjetër që është “Master shkencor” penal në vitin 2020-2022.

Po t’i referohemi edhe të dhënave tabelare të përcjella nga Shkolla, por edhe ato

të cilat janë përpunuar nga nëpunësit tanë, të cilat janë pjesë e materialeve të kësaj mbledhjeje, rezultojnë që për kandidatin në fjalë, sipas Shkollës, është referuar fakti që ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në 12.07.2018, pra e theksoj 12.07.2018. Që do të thotë, Shkolla i është referuar studimeve universitare të kryera nga kandidati deri në korrik të vitit 2018. Për ta perifrashuar me gjetjet, në relacion thuhet që diplomë “Bachelor” 2013-2016, “Master i shkencave” në të drejtë civile, 2016-2018. Që do të thotë, sipas këtij referimi i është referuar mesatares të këtyre studimeve universitare dhe në tabelë rezultojnë mbi 8. Ndërkohë që nga verifikimet e bëra nga nëpunësit, duke iu referuar mesatares së bachelor-it dhe mesatares së lëndëve që ka zhvilluar në programin “Master” në të drejtë civile, rezultojnë mesatarja 7.6 për lëndët mesatare e përgjithshme me mesataren e veçantë. Ndërkohë, krijohet ideja që kjo mesatare mbi 8 (në atë perceptimin tonë) është përlogaritur nga mesatarja e bachelor-it të kryer në 2013-2016 me mesataren e programit “Master” të kryer në vitin 2020-2022. Por vlen të theksohet, në rubrikën ku ka përfunduar studimet, vetë Shkolla ka thënë Universiteti i Tiranës 12.07.2018. Që do të thotë, deri në këtë datë përlogariten çfarë studimesh universitare ka kryer, që sipas të dhënave rezultojnë që ka kryer një “Bachelor” 2013-2016, dhe më tej ka vazhduar me “Master-in” 2016-2018.

Alban Toro: Pra Ilir, për ta kuptuar, “Masteri shkencor” në të drejtën penale 2020-2022 nuk përfshihet tek sistemi i integruar në drejtësi ku ligji kërkon pikët minimale? Pra në rastin konkret Shkolla e Magjistraturës ka një akt nënligjor që e ka përcaktuar në notën 8, pra mesatarja 8. Ky këtu përfshihet në këtë sistem, gjithmonë duke pasur parasysh edhe dispozitat ligjore të ligjit “Për arsimin e Lartë”, i cili thotë në pikën (nenin) 76 “Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë.”. Sepse është pak si e paqartë kjo situata e arsimit.

Ilir Rusi: Atëherë, më duhet të bëj edhe një shpjegim për shkak edhe të

përkatësisë në Këshill si nga radhët e pedagogëve, që do të thotë që zotëroj modestisht një njohuri mbi ligjin “Për arsimin e lartë”.

Në vijim të studimeve “Bachelor”, zhvillohen studimet e ciklit të dytë, me dëshirë, sepse arsimi i lartë është fakultativ, nuk është i detyrueshëm dhe dy programe studimi në një kohë nuk lejohet. Që do të thotë që një kandidat nuk mund të zhvillojë dy programe studimi në të njëjtën periudhë kohore, pra njëkohësisht të bënte edhe një “Master shkencor” në të drejtë civile dhe një “Master shkencor” në të drejtë penale (në rastin konkret). Po të shikojmë ato janë në kohështrirje të ndryshme nga njëra-tjetra.

Pas përfundimit të ciklit “Bachelor” (në atë perifrazim që bëtë ju), vazhdojmë me studimet e ciklit të dytë, dhe ka përfunduar, dhe ka përfunduar ciklin e dytë, dhe këto quhen studime të plota universitare. Kur aplikon më tej pas studimeve të plota universitare, çdo individ i cili zotëron një diplomë në programin “Bachelor” dhe ciklit të dytë, në rastin e “Masterit shkencor” penal rezulton që ai aplikon për degë të dytë, do të thotë që e ka përfunduar studimet dhe bën një degë të dytë. Pra do të thotë që ka përfunduar studimet universitare të plota dhe studimet universitare të plota (jo vetëm për të, por për të gjithë këta) janë ato që kryhen në vijueshmëri pas përfundimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe kryen edhe një cikël të dytë në një profil që dëshiron vetë. Këtu përfundon studimet e plota. Çdo konkurrim që bëhet më tej pas këtyre studimeve, me këto diploma universitare, quhen degë e dytë.

Kështu që, në frymë të ligjit, studimet universitare të plota janë në vijueshmërinë e kohëzgjatjes së tyre, pas “Bachelorit” kryen dhe ciklin e dytë dhe i ke përfunduar studimet e plota universitare në drejtësi. Për më tej, është përsëri dëshira apo kërkesa e gjithsecilit për të marrë njohuri, por studimet e plota universitare i ke përfunduar.

Marçela Shehu: Ilir, kisha unë një pyetje të lutem.

Kjo që ju sapo shpjeguat dhe sqaruat, është e cituar diku në ligjin “Për arsimin e lartë”?

Ilir Rusi: Cila zonja Shehu?

Marçela Shehu: Që, për sa i përket vijueshmërisë, masteri i parë përbën ciklin që duhet të ndiqet për t'u konsideruar studime të plota universitare.

Ilir Rusi: Tani, e nderuar, dijenia mbi ligjin është në raport me leximin e ligjit. Megjithatë, studimet universitare përbëhen nga cikli i parë, i dytë dhe i tretë. Me përfundimin e ciklit të parë dhe të dytë, përfundojnë studimet e plota universitare, në raport me konkurrimet përkatëse. Për më tej pastaj, unë ju dhashë shpjegimin. Nëse me zotërimin e këtyre diplomave konkurron për diçka tjetër, kjo quhet degë e dytë. Pra do të thotë që ti bën diçka shtesë, por i ke përfunduar studimet e plota universitare. Po ta lidhim edhe arsimimin me punësimin, me zotërimin e një diplome “Bachelor” mund të konkurrosh për nivele më të ulëta ekzekutive; me zotërimin e një diplome “Bachelor” dhe të ciklit të dytë, mund të konkurrosh edhe për nivelet e tjera në administratë dhe kjo do të thotë që me zotërimin e këtyre dy diplomave i ke përfunduar studimet universitare.

Alban Toro: Më fal Ilir, një shpjegim të vogël.

Referove që ka një studim të tretë, cikël studimesh, apo jo?

Neni 77, po i këtij ligji, na thotë që: “Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve “Master ekzekutiv”, ...” që janë programe shumë më të avancuara. Në rastin konkret po flasim për “Master shkencor”, vazhdojmë të jemi tek i njëjti program, programi i ciklit të dytë të studimeve. S’kemi kaluar tek cikli i tretë. Pra ky zotëria na paska një “Bachelor”, ka edhe dy mastera të njëpasnjëshme.

Ilir Rusi: Atëherë, ku është pyetja?

Alban Toro: I pari ishte një sqarim, se na referove që është program i tretë, cikël i tretë studimesh, pra e konsiderove si cikël të tretë studimesh. Këtu nuk kemi...

Ilir Rusi: Jo, jo, nuk e konsiderova fare i nderuar.

Thashë: “...përbëhet nga cikli i parë, i dytë dhe i tretë (studimet)”.

Alban Toro: Po pra, në rastin konkret s’kemi cikël të tretë studimesh, se është “Master ekzekutiv”.

Ilir Rusi: Nuk po e sqaroja ciklin e tretë në raport me rastin. Se “Master ekzekutiv” është master i ciklit të tretë, ke dhe Doktoraturën si cikël të tretë, por nuk është rasti këtu. Të lutem, unë dhashë një perifrazim të ligjit në raport me pyetjen e bërë nga kolegja, kurse sqarimi se deri ku shkon kohëzgjatja e studimeve të tij për t’u konsideruar studime të plota universitare, më duket se e dhashë. Unë po sqaroja më tej kolegen mbi përcaktimet ligjore që ka në raport me vijueshmërinë e studimeve universitare, që është cikli i tretë i “Masterit ekzekutiv”, por kjo është diçka tjetër, nuk ka të bëjë me rastin konkret.

Naureda Llagami: Atëherë, me sa kuptova edhe nga Albani, meraku që ne kemi është që tek propozimi që ju keni, të japim më mirë detajet për të gjitha ato persona që sugjerohet nga Komisioni dhe që do votohet nga mbledhja plenare, shkaqet dhe arsyet pse ne... (jo të jetë diçka e përgjithshme), por të jepet në mënyrë më të detajuar argumentimi i propozimit që kemi ne, apo sugjerimi që po i japim Shkollës për secilin rast, në mënyrë më të individualizuar.

Ilir Rusi: Dakord.

Brikena Ukperaj: Zoti Rusi, Komisioni është dakordësuar tërësisht lidhur me këtë material që i sillni sot plenares me këtë propozim? Në Komision, e keni dakordësuar tërësisht, të tre anëtarët?

Ilir Rusi: Jo vetëm një herë por në mënyrë të njëpasnjëshme e kemi dakordësuar materialin, me qëllim që ai të finalizohet në formatin që ju ka ardhur, e theksoj, me

përrjashtim të lapsusit të bërë, për shkak se janë punuar disa materiale, dhe kjo tregon që Komisioni, në vijueshmëri ka pasur qëndrimet e veta dhe lapsus është përcjellë një material i cili ka qenë i një kohe të mëparshme të Komisionit, para se të vendoste për përcjelljen e akteve mbledhjes plenare.

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Dritan Hallunaj: Nëse mund të shtoj diçka?

Naureda Llagami: Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Atëherë, edhe Komisioni e ka sjellë aty që ne ta diskutojmë të gjithë bashkë në seancë plenare. Pra ato problematika që ne kemi hasur, ne nuk kemi thënë as kualifikim, as skualifikim; ne kemi thënë hajde ta diskutojmë të gjithë bashkë dhe të vendosim, ashtu siç ka qenë edhe praktika në vitet e tjera. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hallunaj!

Atëherë, nëse nuk kemi më diskutime, ta kalojmë në votim projektpropozimin e përcjellë nga Komisioni, bashkë me sugjerimin që në fakt edhe për pjesë të sqarimeve që tha Albani dhe që unë në fakt ia sugjerova kryetarit të Komisionit, ta kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Marçela Shehu: Kryetare, më fal!

Naureda Llagami: Prit!

Marçela, se hymë në votim në fakt dhe s'e kemi këtë proces, që kur hymë,

shprehim votën, ta ndalojmë.

Marçela Shehu: Fillimisht, a mund të pyesim a kemi ndonjë propozim për ndryshim, – apo jo?

Naureda Llagami: Kaluam pra në votim. I bëra pyetjet.

Marçela Shehu: Jo pra, ishim në diskutime Kryetare. Unë pasi mbarova diskutimin dhe dëgjova përgjigjen, kisha një propozim, vetëm për zotin {...}, jam me të njëjtin mendim që ka edhe Shkolla e Magjistraturës. Ky ishte propozimi im.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë vetëm për zotin {...}, duke qenë se Marçela nuk na dëgjoi, komunikova më shpejt unë.

Marçela Shehu: Ndjesë...

Naureda Llagami: Në fakt unë doja jo vetëm për zotin {...}, unë doja për të gjithë tani, në qoftë se është i njëjti standard që kemi mbajtur me të gjithë skualifikimet, se ne si zoti {...} i kemi të gjithë kandidatët. Kështu që, Ilir edhe një herë, nëse është i njëjti standard për të gjithë skualifikimet që Komisioni të paktën na sqaroi këtu? Se kjo është edhe arsyeja që kërkova Marçela që të sqarohet për të gjithë të tjerët.

Alban Toro: Ka kërkuar të rivlerësohet, jo ta skualifikojë.

Naureda Llagami: S'kemi skualifikuar. Rivlerësim kemi kërkuar.
Sugjerimi ynë për Shkollën...

Alban Toro: (Pa mikrofon.) Ata e kanë kualifikuar, ky i thotë ta rivlerësojnë edhe një herë këtë kualifikimin.

Naureda Llagami: Si {...} janë të gjithë të tjerët. Të paktën me sa kuptova nga relatimi, dhe për këtë arsye i kërkova zotit Rusi që të sqarojë edhe Shkollën kur të çojë për sugjerim rivlerësimi të gjithë kandidatët, jo vetëm zotin {...} që ju kërkua (me të drejtë), por të gjithë emrat që janë këtu, për efekt transparence.

Meqë zonja Marçela ka bërë propozim konkret vetëm për zotin {...}...

Ilir Rusi: Duke marrë shkas nga pyetja e zotit Toro, çdo pyetje është e pranueshme, dhashë edhe një herë kriteret dhe referencat që ka përdorur Komisioni i vlerësimit në lidhje me vlerësimin e të gjithë kandidatëve; dhe vlen të theksohet fakti që Komisioni ka përdorur të njëjtat njësi matëse në lidhje me mesataren dhe me vitet e punës, për të gjithë kandidatët të cilët janë përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, pavarësisht nga rubrika përkatëse nëse janë tek seksioni i të kualifikuarve nga Shkolla e Magjistraturës apo seksioni i të skualifikuarve. Në, në raport edhe të bashkëpunimit, edhe sipas praktikave të mëparshme të Këshillit, kemi përzgjedhur fjalët duke kërkuar dhe sugjeruar edhe një herë rivlerësimin e këtyre kandidatëve. Pastaj është në vlerësimin e institucionit, në këtë rast të Shkollës së Magjistraturës, nëse bën rivlerësimet e tyre apo të të gjithëve, kjo është në çmuarjen e vet, në diskrecionin e vet. Por ne kemi sugjeruar që të bëhet rivlerësimi i tyre sipas metodologjisë të përdorur nga ne, në raport me përcaktimet ligjore ashtu edhe me aktet e tjera të nxjerra nga organet përkatëse.

Naureda Llagami: Atëherë, Shkolla në fakt, për kujtesë, edhe vjet ne kemi bërë sugjerime, duke qenë se jam anëtare e bordit, dhe Shkolla nuk i ka pranuar sugjerimet e bëra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Unë mendoj që duke qenë edhe anëtare e bordit, për ta përçuar më mirë vendimmarrjen e Këshillit, do të ishte mirë që ne të sqaronim më mirë (jo t'i lëmë në gjëra të përgjithshme), për të kuptuar edhe Shkolla interpretimin e ligjit që kemi ne.

Atëherë, pa humbur kohë, me gjithë sqarimet që dhamë, kalojmë në votim të propozimit të zonjës Shehu, dhe më pas propozimit në tërësi të projekt-aktit.

Ilir Rusi: Kundër propozimit.

Irena Plaku: Kundër, për sa kohë që është një qëndrim i mbajtur nga Këshilli edhe vitin e kaluar, megjithëse nuk janë bërë sqarimet e mëtejshme, por është një qëndrim i mbajtur jo vetëm për {...}, por për të gjithë kandidatët e tjerë.

Dritan Hallunaj: Kundër, jo vetëm për sa i përket qëndrimit që ne kemi mbajtur, por edhe diskutimit të përbashkët, që ne do flasim, do diskutojmë, pastaj opinioni ynë do t'i dërgohet Shkollës. Prandaj jam kundër.

Ridvan Hado: Kundër, me të njëjtat argumente që sapo thanë kolegët, pasi është çështje parimore që është mbajtur qëndrim edhe në vitet paraardhëse.

Alban Toro: Dakord, sepse s'ka pasur rast të ngjashëm dhe nuk kemi pasur një standard të mëparshëm me të njëjtin format, pra nuk ka pasur diskutime të numrit të caktuar të mastarëve që ka disponuar kandidati, kështu që nuk mund të themi që kemi pasur një standard të parë dhe tani po shkelim standardin. Ky është një rast specifik i cili duhet të ishte trajtuar më me kujdes, më i arsyetuar. Kështu që, për këto arsye jam dakord që të kalojë të kualifikohet.

Fatmira Luli: Kundër, për shkak të faktit që mos të flasim me emra, por kemi mbajtur një qëndrim për raste të tilla analoge. Pastaj kur vijmë tek emrat, duhet t'i përshtatemi qëndrimit që ne kemi vendosur paraprakisht për rastin.

Marçela Shehu: Kam përshtypjen që nuk ishte diskutim emri, unë e kam për rregullin. Unë nuk mbaj mend dhe nuk jam në dijeni, që një diskutim i tillë të jetë bërë në vitet e tjera për kandidatë të tjerë. Jam pro propozimit.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër propozimit, duke shprehur dakordësinë me argumentimin e zotit Rusi.

Naureda Llagami: Kundër propozimit.

(Nuk miratohet propozimi i zonjës Shehu.)

Naureda Llagami: Kalojmë në votimin në tërësi të projekt-aktit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni, me gjithë sugjerimet për sqarime të mëtejshme.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, profili gjyqtar, për vitin akademik 2023-2024”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit për punën.

Faleminderit Komisionit për punën voluminoze.

Punë të mbarë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor